

Caritas



Zyret e Caritas Kosovës

Ferizaj

Sheshi Imzot Nikë Prela
70 000 Ferizaj,
Kosova
tel.00381 290/328-110
fax. 00381 290/396-588
caritaskosova@hotmail.com

Prishtinë

Rr. Rustem Statovci
10 000 Prishtinë,
Kosova
tel. 00381 38/558804
mob. 00377 45/410441
dh_prokshi@live.com

Gjilan

Rr. Haki Mynderrizi, Nr.49
60000 Gjilan,
Kosova
tel. 00377 44/397273
arbenkeka@hotmail.com

Prizren

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 1
20 000 Prizren,
Kosova
tel. 00381 29/244 875
caritasprizren@yahoo.com

Mitrovicë

Rr. Tirana, Nr.101
40 000 Mitrovicë,
Kosova
tel.00381 28/530-250
caritas_mitro@hotmail.com

Novosellë - Gjakovë

Novosellë e Eperme -
Kisha katolike "SHËN RROKU "
50.000 Gjakovë,
Kosova
tel. 00377 44/709 327
homecare_novo@live.com

Suharekë

Rruga e Reçanit
23 000 Suharekë,
Kosova
tel. 00377 45/376 030
h.csuhareka@gmail.com

Caritas Kosova

Raporti Vjetor 2011



PËRMBAJTJA

- | | | |
|---|--|--|
| 1. Fjala Hyrëse...3 | 10. Reduktimi I rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore-emergjencat...13 | 19. Shëndeti dhe ndihma sociale...23 |
| 2. Programi i Përkujdesit Shtëpiak...4-5 | 11. Forcimi i integritetit të Komuniteteve RAE në Komunën e Prizrenit...14 | 20. Qendra për rehabilitimin e personave të varur nga substancat narkotike ...24 |
| 3. Forcimi i Rrjetit të organizatave civile mbi personat me nevoja të veçanta...5-6 | 12. Programi mbështetës për të rinjtë dhe fëmijët e Mitrovicës ...15-16 | 21. Përforcimi i Konkurrencës se agro-bizneseve dhe zhvillimi I turizmit rural në Kosovën Jugore ...25 |
| 4. Programi i anti-trafikimit...6-7 | 13. Shpërndarja e ndihmave humanitare...16-17 | 22. Buxheti 2011...26-27 |
| 5. Asistencë për të kthyerit vullnetarë...8 | 14. Programi nacional për personat me nevoja të veçanta...17-18 | |
| 6. Mbështetje strategjisë së BE-së për implementimin e projekteve dedikuar komuniteteve RAE...9 | 15. Programi Diocezian i animacioneve...19-20 | |
| 7. Zbulimi dhe Edukimi i Hershëm i fëmijëve me nevoja të veçanta...10 | 16. Të rinjtë, si faktor të ndryshimit...20 | |
| 8. Përforcimi i organizatave të fermerëve dhe mbështetje në qëndrueshmërinë e agro-bizneseve në Regjionin e Ibrit ...11 | 17. Gratë së bashku për të drejtat e njeriut...21 | |
| 9. Projekti i Promovimit të Pages...12 | 18. Programi socio-pastoral ...22 | |

Përgatiti: Caritas Kosova
Dizajni: ©Lex-Lekë Laçi





“Unë nuk jam i vetmuar – dikush kujdeset për mua”

“Përkujdesi Shtëpiak”

Shtrirja: Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Novosellë, Suharekë;

Donatorët/Partnerët: Caritasi Gjerman –DCV; Komuna e Suharekës;

Kohëzgjatja: 2009

. V Ö P Ö N Ç P V C E V Ö N Ö N Ç P V përkujdesit shtëpiak në sistemin social dhe shëndetësor të Kosovës, familjet ngelin të pafuqishme përballë sfidave të tyre të përditshme, në përkujdesjen e anëtarëve të tyre me nevoja të veçanta dhe me sëmundje kronike. Sëmundjet më të shpeshta nga të cilat vuajnë të moshuarit janë: probleme në pamje dhe dëgjim, çrregullime të sistemit nervor qendror, sëmundjet e zemrës, tension të lartë të gjakut dhe nivelit të sheqerit. Edhe pse këto sëmundje



në shumicën e rasteve nuk kërkojnë hospitalizim, megjithatë kërkohet trajtimi me medikamente dhe këto sëmundje paraqesin pengesa serioze tek njerëzit e prekur. Obligime të rëndësishme ditore si: higjiena personale, ngritja nga shtrati, pastrimi i shtëpisë, veshja dhe pazaret, shpesh herë nuk mund të menaxhohen nga të moshuarit e vetmuar (apo të braktisur). Në këtë kontekst, projekti “Përkujdesi Shtëpiak” është hartuar për të trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojat e personave të sëmurë dhe atyre me nevoja të veçanta duke përfshirë familjet e tyre apo përkrasit e tjerë siç janë: të afërmit, fqinjët dhe vullnetarët. Fakti që nevojat e lartpërmendura paraqiten tek shumë njerëz të moshuar në tërë Kosovën, qëllimi i përgjithshëm i projektit është që të krijojë një sistem të kujdesit në shtëpi në nivel nacional me qëllim të përmirësimit të jetesës dhe shëndetit të të moshuarve, njerëzve të sëmurë, me sëmundje kronike, personave me nevoja të veçanta dhe personat që përkujdesen për ta.

“Ju mund të shihni dhe vetë se në çfarë kushtesh jam duke jetuar, i braktisur duke u përballur me një varfëri ekstreme dhe me sëmundje të rëndë; jeta është e vështirë pa një fëmijë. Nëse dhe infermieret e „Përkujdesi Shtëpiak” nuk do të vinin çdo ditë të trokasin në derën tone, për të shëruar plagët tona dhe për tu kujdesur për ne, unë mendoj se për një kohë jo shumë të gjatë do të ishim të harruar nga të gjithë,” thotë N.D. – një nga përfituesit e projektit „Përkujdesi Shtëpiak” në Suharekë. Ndërsa, burri i saj N.XH. na tha: “Kur ekipi i „Përkujdesi Shtëpiak” viziton shtëpinë tonë, ata nuk duhet të trokasin në derë, ata vijnë lirshëm në shtëpi sepse ato tani janë bërë si bijat tona. Jeta ime, si një 80 vjeçar do të ishte më e vështirë dhe e padurueshme pa trajtimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e infermiereve të Caritas-it. Unë, po ashtu dhe gruaja ime, vuajmë nga sëmundje kronike, dhe nuk jemi në gjendje të kujdesemi për njëri tjetrin, kështu Zoti i bekoftë infermieret dhe Caritas-in të cilët na vizitojnë rregullisht.”

Gjatë vitit 2011, përveç përforsimit të asistencës së “Përkujdesi Shtëpiak”, Caritasi ishte i përqendruar po ashtu në promovimin e projektit tek institucionet e Kosovës në nivel nacional dhe lokal, duke rritur përfshirjen e vullnetarëve dhe duke forcuar bashkëpunimin me Famullitë e Caritas-it. Një tjetër aspekt i rëndësishëm ishte vlerësimi i suksesshëm dhe përfundimi i fazës së parë të projektit e cila është pasuar në përgatitjen e fazës në vijim.

Qeveria e Kosovës dhe autoritetet lokale kanë filluar të shohin përkujdesjen shtëpiake si një mënyrë e duhur për të siguruar qasje shëndetësore. Prandaj, ky projekt është duke shërbyer si model për dhe përkushtimit të ekipeve “Përkujdesi Shtëpiak” përveç regjioneve shtine, Novoselle dhe Prizren, sot është duke u implementuar me e Suharekës. Ne tani më jemi duke negociuar edhe për një fillim të Komunën e Vitisë, Rahovecit dhe Klinës.

A group of people in wheelchairs are playing basketball on a large indoor court. The court has a blue and yellow floor. There are spectators in the background and a basketball hoop visible.

Në mënyrë që të avancojmë pozitën e personave me nevoja të veçanta në shoqëri dhe të përmirësojmë kapacitetet e rrjetit të këtyre shoqatave të cilat karakterizohen me mungesë të: rrjeteve mes tyre, identifikimin e nevojave të tyre, aftësitë organizative, Ciklin e Menaxhimit të Projektit, relacionet me institucionet dhe komunitetin; projekti është duke implementuar aktivitete të tilla si: aktivitete mbi ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnime, tryeza të rrumbullakëta, takime të komunitetit, krijimin e Grupeve për Vetë-përkrahje si dhe ngjarje dedikuar anti-stigmave.

me Qendrën Kosovare për Vetë-përkrahje ,financuar nga Caritas-Italian është duke implementuar projektin “Forcimi i rjetit të shoqatave të shoqërisë civile që punojnë me personat me nevoja të veçanta në rajonin e Gjilanit (Kosovë)” projekt ky, i cili filloi fazën e tij të dytë në tetor të vitit 2011.Objektivi i projektit është forcimi i shoqatave të shoqërisë civile të personave me nevoja të



Në këtë kontekst, nëpërmjet takimit të Bordit Drejtues, u arrit krijimi i një ekipi të rrjeteve i përbërë nga organizatat e personave me nevoja të veçanta me qëllim të dakordimit mbi vendimet e përbashkëta, aktivitetet e avokimit dhe planifikimit. Organizatat të cilat vepronin si konkurrentë arritën një qasje të koalicionit. Ekipi i rrjetit punues po vazhdon aktivitetin e tij në vlerësimin e nevojave si dhe avokimin në fushat e ndryshme siç është paraparë në Planin Nacional të Veprimit për personat me nevoja të veçanta. Në këtë mënyrë, projekti ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme të këtyre personave, përkatësisht në menaxhimin profesional, tek udhëheqësit dhe aktivistët, në mënyrë që të ofrojnë shërbime


për nevojat e komunitetit të tyre si dhe ka ndikuar në fuqizimin e përfaqësimit të tyre në nivel lokal dhe në atë nacional.

Projekti ka kontribuar në uljen e paragjytimeve ndaj njerëzve me nevoja të veçanta përmes fushatave dhe veprimeve sportive të realizuara me përfshirjen e komunitetit. Për më tepër, është realizuar hulumtimi i quajtur “Qasja dhe përceptimet ndaj njerëzve me nevoja të veçanta” në bashkëpunim me Universitetin Bicocca të Milanit.

Përveç kësaj, krijimi i Grupeve ‘Vetë-përkrhëse’ ka formuar një lidhje të forte mes shoqatave dhe përfituesve. Është mundësuar shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në lidhje me qëndrueshmërinë, dizajnimin e projektit, zbatimin efektiv të aktiviteteve dhe aktiviteteve mbi gjenerimin e të ardhurave që do të mundësonin një jetë më cilësore për personat me nevoja të veçanta. Projekti, ka ndikuar pozitivisht në rritjen e numrit të personave me nevoja të veçanta në veprimtarinë dhe qeverisjen e shoqatave të tyre, si dhe në integrimin e tyre në shoqëri dhe krijimin e bazave për vet-qëndrueshmërinë e aktiviteteve të tyre të iniciuara nga ky projekt.

Sa i përket ndikimit të programit në punën e tyre të përditshme, Bajram Spahiu – koordinatori i Shoqatës ndër-komunale të personave të verbër dhe me të pamë të kufizuar tha se: “Projektet e Caritas Kosova kanë ndikuar pozitivisht në gjendjen e përgjithshme të organizatave tona. Ka një përfshirje më të madhe të personave në aktivitetet dhe projektet e organizatës si dhe një bashkëpunim intensiv me institucionet vendore dhe palët tjera. Thjeshtë, këto projekte i kanë dhënë ngjyra të reja punës sonë.”

Së bashku në luftim të trafikimit!



Është koha për të luftuar trafikimin!

Konsolidimi i kapaciteteve për të ndihmuar viktimat e trafikimit në Kosovë

Shtrirja: Nivel nacional

Kohëzgjatja: 2011

Donatorët/Partnerët: Caritas France, Caritas Zvicra dhe CRS

Caritas Kosova është pjesë e programin nacional të Anti-Trafikimit, me qëllim të ri-integrimit psiko-social të viktimave të trafikimit në Kosovë. Objektivi i projektit është konsolidimi i aftësive menaxhuese të stafit të strehimoreve ekzistuese për integrimin psiko-social dhe ekonomik të viktimave, ku përmes menaxhimit të strehimoreve të arrihet të kuptohet më mirë situata e viktimave, rrethanat e tyre socio- ekonomike dhe të fitohen njohuri (“ know-how”) për integrimin e viktimave, duke përfshirë realizimin e fushatave ndërgjegjëse për publikun



Koalicioni, arriti që gradualisht të rris bashkëpunimin në nivel nacional, duke zgjeruar shtrirjen e veprimtarisë me synim të një ri-integrimi më të mirë dhe të qëndrueshëm të viktimave të trafikimit në shoqëri, përmes punësimit të tyre në komunitetin e biznesit.



Kthimi në shtëpi – Ndryshim i perspektivës!

Përforcimi i asistencës adekuate për të kthyerit vullnetarë

Shtrirja: Nivel Nacional

Kohëzgjatja: 2009

Donatorët/Partnerët: Caritas Internacional i Belgjikës (financuar nga EU dhe fondet Ndërkombëtare Belge, nëpërmjet Ministrisë së Integrimit Social dhe agjensisë së tyre shtetërore - Fedasil)

V V ÑNM QD ÇĆCEAE FMOME
Kosova është duke implementuar projektin në nivel nacional “asistencë adekuate për të kthyerit vullnetarë, projekt ky i mbështetur nga Caritas Nacional i Belgjikës, i cili synon rritjen e mundësive të një ri-integrimit të suksesshëm të emigrantëve të kthyer vullnetarisht (të orientuar në mikro-biznese) pas qëndrimit të tyre në Belgjikë. Pas kthimit të tyre në Kosovë, Caritas Kosova siguron mbështetjen e nevojshme në hapat e tyre të pare drejt ri-integrimit, përmes forcimit të asistencës adekuate, duke iu referuar natyrës së nevojave të çdo individi të kthyer, në marrëveshje me ta.



Gjatë vitit 2011, dhe në vazhdimësi, Caritas Kosova ka mbështetur suksesshëm ri-integrimin e 45 rasteve, të cilat përfshijnë 104 persona, të kthyer në Kosovë individualisht ose me familjet

e tyre. Të kthyerit janë ndihmuar me anë të mikro-bizneseve, konsultimeve dhe vizitave në terren, të cilat kontribuuan në krijimin e bizneseve të ndryshme sikurse: prodhimi i qumështit, fermat e pulave/lopëve, taksi, auto-mekanik, auto-larje, mishtore, zdrukhtari, rrobaqepës, etj. Në anën tjetër, janë ndarë po ashtu fonde për rastet me të rënda në mënyrë që të mbulohen trajtimi shëndetësor, edukimi, blerja e mobileve elementare dhe pagesa e qirasë ose për të mbuluar nevoja tjera të veçanta të përfituesve. Ky projekt, deri më tani ka kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së të kthyerve dhe sigurimin e të ardhurave për një mirëqenie të qëndrueshme për të kthyerit e ri-integruar. Konkretisht, Basri R. ka qenë pjesë e skemës së mikro-biznesit të të kthyerve, si një nga përfituesit e projektit të mbështetur drejtpërdrejtë nga Caritas Kosova në ri-integrim. Pasi vendosi të kthehej



vullnetarisht nga Belgjika, ai është kthyer në Kosovë në gusht të vitit 2011. Në takimet e para me të, ai kishte planifikuar që të hapë një bar kafe, por në bashkëpunim me këshilltarin e Caritas-it, ai vendosi që

përfundimisht të investonte fondin e tij për ngritjen e një mikro-biznesi. Ai menjëherë themeloi ndërmarrjen e tij, duke blere pajisje të nevojshme nëpërmjet fondit të dedikuar për të. Që atëherë, ai ka fituar mjaft kontrata afatshkurtra për vendosjen e qeramikave. Si rezultat i të ardhurave të gjeneruara përmes vendosjes së qeramikave, ai tani është në gjendje t'i mbulojë shpenzimet e studimeve universitare pranë Departamentit të Ekonomisë dhe Financave, ku është regjistruar si student me korrespondencë. Ai është shumë mirënjohës për asistencën e dhënë nga Caritasi e cila i ka mundësuar atij të fillojë një jetë “të re” në Kosovë, dhe të ketë një mendim pozitiv për të ardhmen, duke thënë se tani është i lumtur, dhe se vendimi për tu kthyer në shtëpi ishte vendimi i duhur.



Të mësuarit mund të jetë kënaqësi!

Mbështetje Strategjisë së BE-se për implementimin e projekteve dedikuar komuniteteve RAE(EU-SIMRAES)

Shtrirja: Regjional

Kohëzgjatja: që nga viti 2009

Donatorët/Partnerët: Komuna e Ferizajt; Komisioni Evropian, SOROS & KEC

h NË QENDRËN SOCIALE DHE EDUKATIVE NË DUBRAVË (FERIZAJ) ME MË SHUMË SE 300 PËRFITUES TË CILËT FREKUENTOJNË QENDRËN ÇDO DITË, PËRBEHET NGA DY KOMPONENTË KYESORE— EDUKIMIN DHE MEDIA/KULTURË. NË KUADËR TË KËTJË PROJËKTI, IMPLEMENTOHEN PROGRAMET SI: PROGRAMI PARASHKOLLOR (mosha 3-6), ndihma në detyrat e shtëpisë-jashtë orëve mësimore(mosha 6-15), programi shkrim/leximit, paketa e asistencës për nxënësit, aktivitetet rinore (ekskursione, aktivitete kulturore) dhe kurse përgatitore. Kurset përgatitore janë të dizajnuara për nxënësit e diplomuar nga shkolla fillore dhe shkolla e mesme të cilët kanë nevojë për përgatitje për testet e pranimit të regjistrimit të ardhshëm në shkollë të mesme apo universitet. Nxënësit dhe prindërit e tyre janë shumë mirënjohës, duke u shprehur se fëmijët e tyre ndjekin me entuziazëm programet e ofruara nga qendra sociale-edukative, e cila ndikon në përmirësimin e performancës së tyre në shkollë, ndikim ky i cili është konfirmuar edhe nga vlerësimet tona të brendshme. Konkretisht, Samire H. nxënëse e klasës së parë, ishte një fëmijë problematik, e cila nuk vijonte mësimin rregullisht dhe karakterizohej me një mungesë të kujdesit higjienik. Ndërsa tani, mësuesja e saj e përgëzon atë për sjelljet e saja të përmirësuar meqë ajo është mjaft e kujdesshme ndaj higjienës dhe rregullisht e pranishme në mësim. Performanca e saj në shkollë është duke u përmirësuar gjithnjë e më shumë, ajo tani është në gjendje të shkruaj dhe lexojë mirë në mënyrë të pavarur. Në këtë kontekst, projekti ndikoi në uljen e analfabetizmit të komunitetit RAE në Dubravë, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për edukim, aktivitete kulturore dhe higjienë. Integrimi social i komunitetit RAE është lehtësuar dukshëm falë aktiviteteve dhe shërbimeve të ndryshme të cilat kanë ndikuar edhe në identifikimin e talenteve të ndryshëm (këndim, shkrim, vallëzim) të cilët po promovohen në vazhdimësi.



Projekti që implementohet në qendrën sociale dhe edukative në Dubravë (Ferizaj) me më shumë se 300 përfitues të cilët frekuentojnë qendrën çdo ditë, përbehet nga dy komponentë kryesore— Edukimin dhe Media/Kulturë. Në kuadër të këtij projekti, implementohen programet si: programi parashkollor (mosha 3-6), ndihma në detyrat e shtëpisë-jashtë orëve mësimore(mosha 6-15), programi shkrim/leximit, paketa e asistencës për nxënësit, aktivitetet rinore (ekskursione, aktivitete kulturore)

dhe kurse përgatitore. Kurset përgatitore janë të dizajnuara për nxënësit e diplomuar nga shkolla fillore dhe shkolla e mesme të cilët kanë nevojë për përgatitje për testet e pranimit të regjistrimit të ardhshëm në shkollë të mesme apo universitet. Nxënësit dhe prindërit e tyre janë shumë mirënjohës, duke u shprehur se fëmijët e tyre ndjekin me entuziazëm programet e ofruara nga qendra sociale-edukative, e cila ndikon në përmirësimin e performancës së tyre në shkollë, ndikim ky i cili është konfirmuar edhe nga vlerësimet tona të brendshme. Konkretisht, Samire H. nxënëse e klasës së parë, ishte një fëmijë problematik, e cila nuk vijonte mësimin rregullisht dhe karakterizohej me një mungesë të kujdesit higjienik. Ndërsa tani, mësuesja e saj e përgëzon atë për sjelljet e saja të përmirësuar meqë ajo është mjaft e kujdesshme ndaj higjienës dhe rregullisht e pranishme në mësim. Performanca e saj në shkollë është duke u përmirësuar gjithnjë e më shumë, ajo tani është në gjendje të shkruaj dhe lexojë mirë në mënyrë të pavarur. Në këtë kontekst, projekti ndikoi në uljen e analfabetizmit të komunitetit RAE në Dubravë, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për edukim, aktivitete kulturore dhe higjienë. Integrimi social i komunitetit RAE është lehtësuar dukshëm falë aktiviteteve dhe shërbimeve të ndryshme të cilat kanë ndikuar edhe në identifikimin e talenteve të ndryshëm (këndim, shkrim, vallëzim) të cilët po promovohen në vazhdimësi.



Më së miri është të fillosh herët!

Është projekt që

Shtrirja: Rajoni i Prizrenit

Kohëzgjatja: 2008


Donatorët/Partnerët: Caritasi Gjerman & Caritasi Dioqezan i Innsbruckut

hershëm është projekt që implementohet nga viti 2008 me mbështetje të Caritasit Gjerman dhe Dioqezes së Innsbruck-ut (Caritas Austria). Ky projekt synon zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ofron ndihmë për prindërit e tyre në trajtimin e kësaj situate. Shumë prindër në shoqërinë tonë, fëmijët e të cilëve janë lindur me nevoja të veçanta, kanë turp të kërkojnë ndihmë dhe nuk din se ku apo si të kërkojnë mbështetje, në mënyrë që fëmijëve të tyre tu ofrohet mundësia e përfshirjes për brenda komunitetit. Ky projekt, ofron mundësi të mira për zhvillimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta (0-6vjeq), ndihmë të veçantë për prindërit e tyre si dhe shërben si një lidhje e institucioneve të edukimit dhe shëndetësisë në integrimin social të këtyre fëmijëve. Motoja e të gjitha aktiviteteve tona brenda kornizës së projektit është: “Ndihma e hershme – ndihma më e mire!”

Më konkretisht, Leari 6 vjeçar është pjesë e projektit që nga viti 2009. Në fillim, familja e tij e kishte të

vështirë të pranonte faktin që fëmija i tyre ishte i diagnostifikuar me autizëm, meqë besonin në besëtytnitë dhe ishin përpjekur ta shëronin atë përmes ritualeve jo-mjekësore. Pas vizitës së parë në Qendrën e Edukimit të hershme në Caritas, kaloi pothuajse një vit derisa prindërit e tij e sollën atë përsëri në qendër, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për vetëdijesim nga ana jonë. Megjithatë, pasi gjendja e tij u përkeqësua, prindërit e tij me në fund e kuptuan që kishin nevojë për mbështetje profesionale, pasi që Leari kishte filluar të bëhej agresiv. Për shkak të sjelljes së tij agresive e cila ishte vlerësuar të jetë shqetësuese për fëmijët tjerë, ai nuk u pranua në kopshtin integruar “Nëna Terezë”. Sjellja e tij karakterizohej nga agresiviteti, çrregullimi në të ushqyer; ai nuk reagoonte ndaj njerëzve tjerë, dhe shqetësohej nga muzika dhe zhurmat tjera.

Megjithatë, ekipi i qendrës ka punuar individualisht me të duke e familjarizuar atë me fëmijë tjerë dhe mjedisin. Pas një viti, Leari u bë me i qetë dhe filloi një jetë normale. Komunikimi i tij u përforcua përmes metodave Pecs (dhënia e çokollatave) kështu që ai filloi shqiptimin e fjalëve, dhe pikërisht kjo metodë kontribuoi në koncentrimin e tij. Si rezultat i kësaj, Leari tani është pranuar në kopshtin integruar, ku ka mësuar edhe të flasë. Sot, ai pëlqen librat ilustrues, sidomos ato me ushqim pasi që shumë pëlqen të haj. Ai po ashtu ka filluar të pikturoj duke përdorur lapsa të ndryshëm, të luaj lojëra me figura, duke krijuar forma të ndryshme. Atij i pëlqen posaçërisht loja me peshqit magnetik.







Për audiencën mjaft të gjerë, gjate konferencës u transmetuan mesazhe të paqes dhe pajtimit nga udhëheqësit fetar. Po ashtu u prezantua Deklarata e Paqes përgatitur nga Caritas-i në bashkëpunim me një rrjet të gjerë të OJQ-ve.



– Illsan A. thotë: “Unë jam shumë i lumtur që jam pjesë e projektit, po ashtu për komunitetin tim është shumë e rëndësishme që ekzistojnë struktura të tilla. Te jesh i përgatitur është gjithmonë e nevojshme, në mënyrë që të veprojmë siç duhet dhe në kohë në rast të fatkeqësive”. Mbi të gjitha, qasja jonë shkon më tej reagimit dhe zbatimit të programeve të asistencës dhe rehabilitimit pas fatkeqësive natyrore. Ne në fakt përqendrohemi më shumë në uljen e ndikimit të fatkeqësive në të ardhmen. Ne mobilizojmë komunitetet që marrin pjesë drejtpërdrejtë në këtë projekt, duke kontribuar në zhvillimin e tyre, kështu që reduktohen pasojat e fatkeqësisë në komunitete. Gjatë vitit 2011, Caritas Kosova ka kontribuar në mënyrë aktive në krijimin e qendrës së burimeve rajonale, e cila do të shërbejë si një strukturë mbështetëse, vlerësoj materialet dhe dokumentet në implementimin e projektit, ofroj këshillime dhe mbështetje për organizatat pjesëmarrëse përmes trajnimeve dhe materialeve të shkruara për vet-studim, dhe do të sigurojë që vlerësimi dhe dokumentacioni i projektit janë të përfunduara pas fillimit të pilot projektit të Caritas-it në komunitete të rrezikuara nga fatkeqësitë.



CŦ ČAC ĆAĖ AĀ BÇÃÄ ÇĤE Å Œ **AČÉ DB ÄÏ ÃÄ DĂ ČAǺBĪ** **AČÉ DB Ĭ B Ă ĈČÆ ČBÅ Ğ**

Shtrirja:Rajoni i Prizrenit

Partnerët/Donatorët: Caritas Zvicra

Kohëzgjatja: 2009

Përmirësimi i
statusit socio-
ekonomik të
komunitetit
RAE, të drejtat

Falë Caritas-it, historia e Valentina P. i takon një historie suksesi. E lumtur ajo flet për arritjet e saja dhe përfitimet nga trajnimi 3 mujor që ajo kishte ndjekur për parukeri, ku pas trajnimit një organizatë ndërkombëtare i dhuroi asaj pajisje për parukeri. Pastaj, ajo u regjistrua në kursin për parukeri të organizuar nga Caritas Kosova. Pas 9 muajsh, ajo përfundoi me sukses trajnimin ku një morri diplomë profesionale. Sot, Valentina me sukses ka hapur parukerinë e saj dhe ka siguruar qëndrueshmërinë e te ardhurave të saja, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e mirëqenies së saj ekonomike dhe sociale. Ajo shpreson që një mundësi e tillë do ju jepet edhe të rinjve të tjerë të komuniteteve RAE të cilët përmes përfitimeve për jetesën e tyre do të kontribuojnë në jetën shoqërore në Kosovë.



Në mbështetje të një cilësie më të mirë të jetesës!

Programi mbështetës për të rinjtë dhe fëmijët në Mitrovicë

Shtirja: Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani;

Partnerët/Donatorët: UNICEF;

Kohëzgjatja: komponenti i dytë 12 muaj; Komponenti i tretë 9 muaj

a Në Mitrovicë, Veriu i Mitrovicës dhe Zveçan, Caritas Kosova është duke implementuar programin mbështetës për fëmijët dhe të rinjtë, program ky që përbëhet nga dy komponentë përkatësisht nga komponenti II dhe III. Komponenti i dytë mbështet edukimin dhe ndërmjetësimin e palëve gjatë procesit të reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit me qëllim të parandalimit të sjelljeve kriminale dhe uljen e dhunës mes nxënësve të shkollës (se mesme; moshë 7-18) përmes trajnimeve që kanë ndikuar në fuqizimin ndërmjetësuesve të barabartë; edukimin e mësuesëve në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe promovimin e sjelljeve jo të dhunshme nëpërmjet aktiviteteve në klube rinore. Në kuadër të këtij programi, u organizuan trajnime për mësuesit e shkollave fillore, ekspertë dhe ekipe të shkollave në lidhje me dhunën ndaj nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme. Si rezultat i kësaj, mësuesit dhe ekspertët me sukses përfunduan trajnimet duke u vetëdijësuar mbi sjelljen jo të dhunshme dhe sistemin gjyqësor për të miturit. Përveç kësaj, ne fuqimisht kemi mbështetur punën e Klubit të Rinisë dhe që nga funksionalizimi i tij u organizuan me sukses aktivitete jashtë-shkollore dhe fushata mediatike.



Në komponentin III, objektivi i Caritas-it ishte sensibilizimi dhe informimi i komunitetit RAE në kampin Osterode mbi masat parandaluese të helmimit nga plumbi që ishin adaptuar kulturës së tyre në mënyrë që të reduktohen rastet e helmimit dhe të përmirësohet cilësia e jetesës së fëmijëve të komunitetit RAE. Përveç kësaj, nëpërmjet këtij programi ne kemi mbështetur pjesëtarë të komunitetit RAE në përmirësimin dhe zhvillimin e kujdesit të fëmijëve, duke përfshirë amësi të sigurt.

Në këtë kontekst, u organizuan aktivitete të ndryshme dhe trajnime për fasilituesit e këtyre komuniteteve dhe koordinimin e tyre me Kryqin e Kuq; vizita të rregullta në kamp nga doktorët, leksione mbi temë të promovimit shëndetësor, terapi psiko-sociale ligjëruar nga Kryqi i Kuq, po ashtu seminare dhe hulumtime të ndryshme. Si rezultat i këtyre aktiviteteve u trajnuan fasilitoret, njohuritë dhe aftësitë e të cilëve u konsoliduan në mënyrë të qëndrueshme. Fasilitoret janë organizuar në tri grupe pune, ku secili grup përbëhej nga dy udhëheqës që kryenin nga 10 vizita në ditë, duke mbajtur ligjërata ditore në kampin Osterode....



Duart që na mbështesin!

Kohëzgjatja: prej 1999

A photograph of two young children standing in a snowy outdoor environment. The child on the left is a girl with long, light brown hair, wearing a light-colored jacket with a colorful pattern. The child on the right is a boy wearing a dark red hooded jacket and dark pants. They are standing next to a stack of several cardboard boxes, some of which are decorated with colorful patterns. The ground is covered in snow, and the background is a bright, overexposed white area.



...Përveq që janë aktiv në mbledhjen e ndihmave humanitare dhe organizimin e transportit të tyre, vullnetarët e Junge Leute Helfen herë pas here organizojnë edhe udhëtime në Ballkan për të vizituar familjet dhe individët që ata kanë mbështetur. Në korrik të vitit 2011, me shoqërimin e Caritas Kosova ata vizituan disa familje që u ndihmuan në Ferizaj, Mitrovicë dhe Prishtinë, të cilët patën rastin të falënderonin drejtpërsëdrejt mbështetësit e tyre dhe të ndajnë me ta historinë e jetës së tyre. Me anë të kësaj, vullnetarët patën mundësinë të përjetonin varfërinë e thelle që mbizotëron në Kosovë dhe të shihnin se si ndihmat e tyre kanë ndryshuar jetën e njerëzve. Gjatë ktyre vizitave, familjet pranuan nga një paketë me artikuj ushqimor dhe higjienik nga vullnetarët, të cilët u pritën me buzëqeshje, mirënjohje, mikpritje dhe dhurata simbolike. Përveç vizitave në terren, vullnetarët patën mundësi të takonin dhe lëshonin e Kosovës, stafin e Caritas-it dhe vullnetarët e tij. Për Caritas-in, vazhdimi i shpërndarjes së ndihmave humanitare dhe ekzistenca e qendrave pranuese janë ura për të arritur tek njerëzit në nevojë, të cilët përbejnë misionin tonë.

Të ecim së bashku!

"Programi nacional për njerezit me nevoja të veçanta

Shtirirja: Nivel Nacional;

"Donatore/Partneret: DCV (Caritasi Gjerman);

"Kohe zgjatja: 3 vite

O UAL LUAL LLLLOCKQ OI I I ALI AU Q OOOAU NI AUOI L I NI ONI AU OI UNO OLI KI OAAI I

"Integritet të tyre në shoqëri përbejnë kornizën e punës të programit nacional për personat me nevoja të veçanta.



"Programi synon mbështetjen e njerëzve me nevoja të veçanta, "ne veçanti favorizon ata që jetojnë në zonat rurale duke u "siguruar atyre qasje në shërbimet shëndetësore, edukim dhe "asistencë sociale, të cilat u kanë munguar atyre apo kanë "qene "të limituara për ta. Përveç kësaj, Caritas-i në mënyrë "të vazhdueshme ka lobuar tek qeveria "dhe ka shërbyer si avokues për "persona me nevoja të veçanta duke "marre pjesë në grupin punues "përgjegjës për planin nacional të "veprimit për njerezit me nevoja të veçanta.



"Programi, është përqendruar "kryesisht në rajonin e Prishtinës,

"Ferizajt, Novoselles, Zllakuqanit, Klines, Gllaviqices, Prizrenit dhe Pejë. Pa relevancë janë "përfshirë" në program, me të cilët Caritasi ka bashkëpunuar për arritjen e objektivave të "aktuara, siç janë: Handikos-i, Handifer-i, shoqata e personave të verbër të Kosovës, "Organizata e Sindromes Down, organizata e personave me vështirësi në degjim si dhe "institucionet tjera përkatëse..



...Caritasi, ka bashkepunuar nga afer edhe me famullite e Caritasit, grupet vullnetare ne zonat e lartpermendura, ne menyre qe te arrije te perfshije sa më shumë njerez me nevoja te veçanta ne aktivitetet e organizuara ne rajonet perkatese.

“Perveç fokusit tek njerezit me nevoja te veçanta, Caritasi po ashtu i ka kushtuar vemendje familjeve te tyre qe shume shpesh kane nevoje per t’u keshilluar dhe mbeshtetur gjatë trajtimit te femijeve qe kane nevoje per kujdes te veçante. Kjo “fushate” e ndergjegjesimit shpiu ne rritjen e pjesemarrjes se femijeve me nevoja te veçanta ne sistemin arsimor, ku me shume se tetembedhete femijeve nga zonat e thella rurale iu mundesua per here te pare te shkojne ne shkolle, gje qe me pare ishte konsideruar si diçka e pamundur nga prinderit e tyre. Perveç keshillave profesionale dhe mbeshtetjes ne kete aspekt, Caritas-i per njerezit me nevoja te veçanta dhe familjet e tyre ka ofruar nje program me aktivite rekreative,



aktivite keto, që sensibilizuan pjesemarrësit mbi çështje te ndryshme lidhur me personat me nevoja te veçanta ne pergjithesi. Thelbi i tere ketyre iniciativave ishte te organizohen ngjarje se bashku me ta dhe jo vetem per ta, ne menyre qe edhe personat me nevoja te veçanta te perfshihen ne menyre aktive ne punen e Caritas-it.

“Veçanerisht programi ne Prizren perbehet nga keto komponentet ne vijim: Shkolla Speciale “NeneTereza” per femijet me veshtiresi ne degjim, kopshti gjitheperfshires i femijeve, laboratori per pajisjet te degjimit, shkolla me konvikt dhe edukimi profesional. Ne kete kontekst, Shkolla Speciale “NenaTereze” per femijet me veshtiresi ne degjim, ofron edukim special mbi gjuhen e shenjave per me shume se njeqind femije, terapi dhe lende tjera ne perputhje me programin per nxenesit me veshtiresi ne degjim. Per me teper, njezet e pese femije me nevoja te ndryshme te veçanta jane regjistruar ne kopshtin gjitheperfshires, kopsht ky i cili bashkepunon me Qendren e Edukimit dhe Detektimit te hershem te Caritas Kosoves ne Prizren.

“Perveç kesaj, laboratori ne Prizren i menaxhuar nga Caritas Kosova, qe ndodhet ne kopshtin gjitheperfshires “NenaTereze” synon te mbuloje nevojat e femijeve me veshtiresi ne degjim te shkolles speciale ekzistuese. Ketu perfshihet puna audio-metrike dy here ne jave, ku percillen kapacitetet e degjimit te nentehdhet e tete femijeve nga e gjithë Kosova; dhe po ashtu rregullohen pajisjet e degjimit. Perveç rregullimit te pajisjeve te degjimit, Caritas Kosova prodhon pajisje te degjimit, per femijet me veshtiresi ne degjim, pas ekzaminimit mjekesor te kapacitetit te tyre te degjimit. Ndersa, konvikti i shkolles frekuentohet çdo jave nga me shume se shtatedhete nxenes te cilet jane pjese e aktiviteve te veçanta rekreative ne sport dhe nxenesit mbeshteten ne kryerjen e detyrave te shtepise. Ekskursionet, po ashtu jane pjese e evenimenteve te organizuara nga Caritas Kosova. Gjithashtu, nxenesit kane mundesi te ndjekin trajnime profesionale ne tri fusha: perpunim te metalit, drurit dhe tekstilit. Punetorite ekzistuese profesionale sigurojne arsimim profesional per femijet me veshtiresi ne te degjuar (mosha 16-22). Caritas-i vazhdon te mbeshtese punetorite me materiale te nevojshme si dhe keshilla.



—Koha për animacione!—

Projekti Dioqezan për Animacione

Shtrirja: Niveli Dioqezan

Kohëzgjatja: 2000

Donatorët / Partnerët: Caritas France (bashkë- financuar nga Caritas Zvicra, Caritas Luksemburgu Caritasi Italian, DCV- Caritasi Gjerman)



Përmes mundësive të barabarta dhe të plota për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me mundësitë e ofruara nga shoqëria, është qëllimi kryesor i projektit, i cili arrihet përmes promovimit të bashkëpunimit mes të rinjve, fëmijëve dhe famullive, projekteve të ndryshme dhe aktiviteteve, duke përfshirë edhe krijimin e rrjetit vullnetar të famullisë. Në kuadër të këtij projekti, janë implementuar aktivitete të ndryshme si: takime (vullnetaret e famullisë, palët e interesuara), seminare me tematika të ndryshme (paqe, solidaritet), trajnime të animacioneve, trajnime për të rinjtë, kampe verore, ekskursione për të rinjtë dhe fëmijët, aktivitete të tjera vjetore, krijimi i rrjetit të vullnetarëve, krijimi i një lige të futbollit dhe organizimi i ngjarjeve të veçanta. Gjatë vitit 2011, poashtu janë organizuar trajnime të ndryshme me qëllim të transmetimit të njohurive bazë tek të rinjtë e famullisë mbi aktivitetet me animacione me fëmijët, veçanërisht fëmijët me nevoja të veçanta duke përfshirë edhe trajnimin “ e di – si” në hartimin e mini-projekt propozimeve. Për më tepër, Caritas Kosova në kuadër të këtij projekti organizon kampe verore duke u ofruar mundësinë fëmijëve në shkollë dhe të rinjve të angazhohen në aktivitete rekreative (dhjetë deri 30ditë) gjatë pushimit të tyre veror tre- mujor. Ndërsa, për të siguruar aktivizimin e të rinjve dhe fëmijëve gjatë tërë vitit, të ashtuquajturat aktivitete vjetore janë realizuar me fëmijë, në fushën e kulturës, sportit dhe edukimit (dramë dhe pikturim), duke inkurajuar vullnetaret e famullisë të angazhohen në aktivitete të ndryshme me fëmijë të të gjitha moshave nga rrethet e ndryshme shoqërore. Në veçanti, të përfshirë ishin fëmijët me nevoja të veçanta, duke rritur kështu përqindjen e tyre në aktivitetet sociale. Përveç implementimit të aktiviteteve të projektit, Caritas Kosova ka organizuar ngjarje të veçanta sikurse: karnavale, 10 milion vjet dhe festimin e Ditës Ndërkombëtare të Vullnetarizmit. Gjatë karnavaleve, më shumë se treqind të rinjve / fëmijëve, u është ofruar mundësia të socializohen, duke vallëzuar dhe kënduar së bashku. Me qëllim të promovimit të punës vullnetare, festimi i ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit, mbledhi më shumë se dyqind vullnetarë të rrjetit Caritas të cilët kontribuan në aktivitete të ndryshme të implementuara nga Caritas Kosova. Me moton; “Ndriçoje të ardhmen, jeto në paqe” ngjarja 10 milion Vjet, u organizua në Kosovë, duke promovuar bashkëpunimin në mes të rinjve dhe fëmijëve, pavarësisht fesë, kombësisë, gjinisë dhe moshës. Me ndezjen e qirinjve në vende të ndryshme, të cilët simbolizojnë Paqen (tek ura, statuja e Nënës Terezë), Caritasi synonte sensibilizimin mbi rëndësinë e paqes, duke mobilizuar qindra njerëz.



i 15-vjecari nga Famullia e Zllakuqanit, është djaloshi te cilin as kushtet e rënda të jetesës së tij, e as nevojat e tij të veçanta fizike nuk e penguan të jetë pjesë e projektit dhe në mënyrë aktive të kontribuoj në implementimin e tij që nga viti 2005 . Edhe pse në fillim, ai hezitonte të merrte pjesë në këtë aktivitet përshkak të nevojave të tij të veçanta, me mbështetjen e fuqishme të pjesëmarrësve të tjerë dhe vullnetareve, sjellja e tij ndryshoi. Ai në vazhdimësi, shprehu dëshirën e tij për tu bërë refer i aktiviteteve të projektit duke deklaruar se: “Unë do të parandaloj çdo lëndim të fëmijëve gjatë aktiviteteve, sepse dua që ata të qëndrojnë në këmbët e tyre, në mënyrë që ata të mund të lëvizin lirshëm në çdo vend që ata duan, pa nevojë për ndonjë ndihmë. Unë jam vërtet mirënjohës për vullnetarët e Caritas-it që mbështesin këto aktivitete dhe gjithmonë insistoj tek prindërit e mi të më marrin në të gjitha aktivitetet duke u thirrur në atë se unë jam refer në Caritas dhe duhet të jem i pranishëm atje”!

Bëhu edhe ti faktor ndryshimi!

Të rinjtë si faktor ndryshimi

Shtrirja: Mitrovicë

Donatorët/Partnerët: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kohëzgjatja: 2 Muaj

5 në vitin 2011 ishte Viti Evropian i Vullnetarizmit, Caritas-i organizoi një fushatë ndërgjegjësimi për të rinjtë kosovarë në mënyrë që të informojë dhe përgatis ata për tejkalimin e sfidave që rrjedhin nga përmbushja e standardeve të BE-se. Protagonistë të kësaj fushate ishin aktivistët e rinjë të OJQ-ve, të cilët do shërbenin si transformues të dijes dhe informacionit, të fituar gjatë trajnimeve të ndryshme. Më konkretisht, aktivistët u informuan mbi domosdoshmërinë e Ligjit mbi Vullnetarizmin dhe Politikën Rinore; po ashtu u ligjërua mbi politikën e BE-së dhe vlerat e tyre drejtuese si dhe u organizuan diskutime me tematikë mbi respektimin e diversitetit, ku në veçanti Mitrovica, u pa si një model ndëretnik në Kosovë. Si konkludim, të rinjtë e Kosovës shfaqen gatishmërinë e tyre për të qenë agjentë të ndryshimit, mirëpo ende ekziston nevoja për ndihmë dhe motivim, në mënyrë që të rriten kapacitetet e tyre, të funksionalizohet potenciali i tyre pozitivisht dhe të rritet ndikimi i tyre në shoqëri lidhur me vetëdijen mbi vullnetarizmin, si një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë civile. Një nga pjesëmarrësit u shpreh: “ Ky trajnim më ka ndihmuar të shoh më shumë alternativa, të bëhem më aktiv në vendin tim dhe të kontribuoj në ndryshime pozitive”.





Përtej paragjykitimeve ekzistuese!

Gratë së bashku për të drejtat e njeriut

Shtrirja: Rajoni i Mitrovicës;

Donatorët/Partnerët: Komisioni Evropian;

Kohëzgjatja: 2009



Gratë së bashku për të drejtat e njeriut implementohet nga Caritas Kosova në mënyrë që të promovojë të drejtat e njerëzve që jetojnë në komunën e Mitrovicës, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare apo origjinës së tyre sociale. Me fjalë të tjera, pesë grupe multi-etnike të përbëra nga femra janë të angazhuar në promovimin e të Drejtave të Njeriut, ku koordinimi i aktiviteteve të tyre mbështetet në nivel komunal. Gratë përfaqësojnë pesë vende të ndryshme të Mitrovicës përkatësisht: Mahalla Rome, Mahalla Boshnjake, Suvido, Kodra e Minatorëve dhe Kampi Osterode.

Pavarësisht prejardhjes së tyre të ndryshme, këto grupe ndajnë me njëra tjetrën shqetësime të ngjashme siç janë: dhuna, izolimi, përjashtimi dhe urrejtja, si rezultat i përkatësisë së tyre etnike. Projekti u ofroi atyre mundësinë e shkëmbimit të përvojave dhe ndikoj që ato të jenë më të hapura në trajtimin e problemeve dhe sfidave. Kjo gjë u ndihmoi atyre të reflektojnë mbi qasjet e transformimit të ciklit të konfliktit: për të kapërcyer paragjykimet, për të krijuar grupe të grave duke u bazuar në besim dhe për të iniciuar dialogun gjithëpërfshirës dhe transformues në Mitrovicë. Udhëheqësve që morën pjesë në këtë program iu ofrua mundësia të njihen me marrëdhëniet multi-etnike,

jetën në zonat e post - konfliktit, avokimin për të drejtat e grave dhe krijimin e një mikro-biznesi. Një hap i rëndësishëm u arrit edhe në zhvillimin e një kulture të përfshirjes sociale në bazë të Drejtave të Njeriut e cila ndikoi në sjelljen e tyre ndaj ndryshimeve dhe paragjykitimeve. Gratë, përjetuan një ndryshim në mentalitetin e tyre duke ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me njëra-tjetrën, duke u ballafaquar me të njëjtat probleme, duke pasur qasje të barabartë në informata dhe duke qenë në gjendje të fitojnë aftësitë e nevojshme për zhvillimin e tyre personal.



Shpirti i Caritas-it në punën tonë të përditshme!

Programi Socio-pastoral

Shtrirja: Nivel Dioqezan;

Partnerët/Donatorët: Caritasi Italian;

Kohëzgjatja: -1999

/ ~~MONTE~~ Caritasi Italian mbështet Caritas Kosovën në implementimin e Programit Socio-pastoral në nivel Dioqezan që nga viti 1999. Qëllimi i këtij programi është mbështetja e Caritas-it të Famullive, vullnetarizmi dhe misioni pastoral. Jemi të përkushtuar në përfundimin e strukturave ekzistuese të Caritas-it të Famullive, iniciativave vullnetare dhe Qendrave të Pranimi të Caritas-it. Përmes këtij projekti, synohet të nxitet dhe përfundohet puna e përditshme që bëhet në Caritas. Ky model është aplikuar në tërë rajonin, ku dhe ka shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet strukturave nacionale të Caritas-it dhe Caritas-it Dioqezan. Mirëpo, pasi që në Kosovë ekziston vetëm një dioqezë, ky program është si një instrument që lidhë Caritasin nacional direkt me Famullitë e Caritas-eve dhe grupet e vullnetarëve. Si një komponent i këtij programi, Ministria Sociale e Famullisë është duke aplikuar në rajon si një projekt të përbashkët me Slloveninë, Kroacinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë, Serbinë, Maqedoninë dhe Bullgarinë.



Gjatë vitit 2011, Caritas Kosova organizoi Konferencën Rajonale të Drejtorëve të Caritas-eve nacionale, nga e cila konferencë u morën vendime të rëndësishme dhe rekomandime të vlefshme lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndër-rajonal, iniciativave të Caritas-eve të Famullive dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta për dy vitet e ardhshme. Programi socio-pastoral, kontribuoj në mënyrë të konsiderueshme në përfundimin e lidhjes mes hierarkisë së Kishës dhe strukturat e Caritas-it, duke filluar nga niveli i Famullisë Caritas deri në nivelin dioqezan, nacional dhe në nivel ndër-rajonal.

Programi, më tepër shërbeu si një platformë për shkëmbimin e informacioneve, praktikave më të mira dhe organizimin e vizitave të përbashkëta studentore, përmes së cilës u ngrit kapaciteti i strukturave të Caritasit. Caritas Kosova, ka organizuar një sërë aktiviteteve gjatë periudhës së festave fetare duke promovuar vullnetarizmin dhe veprimtarinë e Caritasit.



Në shërim të plagëve të fëmijëve!



Shëndeti dhe ndihma sociale

Shtirirja: nivel nacional;

Partnerët/Donatorët: Parrocchia Santa Maria Regina, Terni - Italy;

Kohëzgjatja: 2004

5

Sandro Sciaboletta, prift në famullinë Santa Maria Regina di Terni, është një humanist italian i cili për herë të parë kishte njohur për se afërmi popullin e Kosovës në vitin 1999. I prekur nga vuajtjet e popullit Kosovar gjatë luftës në Kosovë, strehimi i refugjatëve Kosovar në famullinë e tij, gjendja sociale, ekonomike dhe shëndetësore në periudhën e pas-luftës në Kosovë, ishin indikatorët të cilët e motivuan këtë prift dhe komunitetin e famullisë së tij të angazhohen dhe të vazhdojnë mbështetjen e popullit të Kosovës që atëherë. Viteve të fundit, ai vizitoi Kosovën më shumë se tridhjetë e pesë herë. Nuk duhet harruar fakti se prifti ynë dashamirës është 78 vjeç dhe tashmë ka përjetuar një sulm në zemër dhe gjendja e tij shëndetësore e kufizon atë në shumë mënyra. Veprimtaria e tij humanitare është përqendruar kryesisht në shëndetësi, ndihma sociale dhe në edukim. Në vitin 2011, janë trajtuar më shumë se dhjetë fëmijë të sëmurë në Itali. Tre-vjeçari U.B. i cili vuante nga “VSD Non-restrictive Membrane Sub-aortica” është një nga rastet e shumta që në sajë të mbështetjes së Don Sandro Sciaboletta u operua në Romë, Bambini Gesù Hospital (Spitali për fëmijë). Fatkeqësisht, ka dhe shumë fëmijë të cilët

po ashtu vuajnë nga sëmundje të rënda që nuk mund të trajtohen në Kosovë. Përveç, që ka mundësuar trajtim mjekësor jashtë vendit, Don Sandro ka kontribuar edhe me një donacionin të madh të pajisjeve shëndetësore në spitalin e Ferizajt dhe në institucione tjera shëndetësore në Kosovë. Don Sandro ka përkrahur popullin e Kosovës në vazhdimësi, përmes ofrimit të ndihmave sociale në forma të ndryshme si : ushqim, veshmbathje, medikamente dhe donacione të tjera. Gjatë vitit 2011, ai ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në promovimin e vullnetarizmit dhe veprimtarisë së Caritas-it përmes organizmit të vizitave studentore me vullnetarë italianë, të cilët kishin rastin të përjetojnë drejtpërsëdrejti punën e Caritas-it në Kosovë. Bashkëpunimi që ai ka krijuar me Caritas Kosovën në fushën e edukimit, rezultuan në mundësimin e studimit të më shumë se pesëdhjetë nxënësve të Kosovës në Itali dhe marrjen e një burse si pjesë e marrëveshjes me institucionet italiane, Caritas Kosovën dhe komunat lokale në Kosovë. Ndërtimi dhe funksionalizimi i Qendrës Sociale dhe Edukative të Caritasit në Dubravë (Ferizaj) është një meritë e madhe e Don Sandro-s i cili ka ndërmjetësuar dhe lobuar në emër të popullit të Kosovës tek Konferenca Ipeshkvore në Itali , e cila ka financuar këtë qendër.



Kthimi në jetë 'normale'!

Qendra për Rehabilitimin e personave të varur nga substancat narkotike (Vërnakollë)

Shtrirja: Nivel Nacional;

Partnerët/Donatorët: Caritas-i Dioqezan Umbria (Itali);

Kohëzgjatja: që nga viti 2010

Vërnakollë (rajoni i Vitisë) është program i iniciuar në vitin 2010 me mbështetje profesionale dhe financiare nga Caritas Umbria. Si pasojë e kërkesave të mëdha që po shtoheshin çdo ditë e më shumë, Caritas Kosova për herë të parë trajtoi një çështje të një natyre aq të ndjeshme. Metodologjia e rehabilitimit që është aplikuar për trajtimin e personave të varur është një qasje inovative, e cila nuk përfshin aplikimin e medikamenteve – gjë që është praktikë e zakonshme gjatë trajtimit si zëvendësim i përkohshëm. Përfituesit, nuk konsiderohen si pacient, ata trajtohen ndryshe! Qëllimi i punës së qendrës është të përkrah në aspektin social personat gjatë fazës së rehabilitimit. Të dhënat e tyre personale janë konfidenciale, duke respektuar



tërësisht dinjitetin e tyre. Gjatë vitit 2011, në programin e rehabilitimit janë pranuar dymbëdhjetë persona, me grupmoshë prej 18-30 vjeç. Katër prej tyre, ishin raste më të vështira të cilët u transferuan në Qendrat e Rehabilitimit më të avancuara në Itali si pasojë e krizave të rënda që ata përjetuan gjatë rehabilitimit të tyre.

Ne mënyrë që të sigurohet një ri-integrim i duhur pas largimit të tyre nga qendra, përfitues të këtij programi janë po ashtu anëtarët e familjeve të personave të varur, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në ri-integrimin social të personave të varur. Mbi veprimtarinë e qendrës, u përgatiten dokumentare televiziv, të cilët u prezantuan në dy transmetime në programet televizive nacionale të cilat përfshinin një audiencë të gjerë. Audiencia kosovare është informuar mbi mundësitë e rehabilitimit në Qendrën e Caritas-it, si dhe personat e prekur u informuan më saktësisht për veprimtarinë e Caritas-it dhe shërbimet që ofron kjo qendër. Përfituesi F.H. (mashkull) është një nga historitë e suksesit: ai filloi rehabilitimin e tij, 2 vite më parë, pasi që kishte humbur plotësisht kontaktin me gruan dhe fëmijët e tij, të cilët ai i kishte braktisur për shkak të mënyrës së jetesës së tij të shfrenuar. Sot, ai vazhdon trajtimin e tij në qendër dhe me sukses është rehabilituar nga varja e tij ndaj drogës. Falë këtij trajtimi ai ka krijuar përsëri marrëdhënie të mira me familjen e tij dhe së shpejti do jetë në gjendje t'i kthehet jetës së tij 'normale'.



y

Përforcimi i konkurrencës së agro-bizneseve dhe zhvillimi i turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës

Shtrirja: Prizren (Regjioni Jugor i Kosovës);

Kohëvgjatja: që nga viti 2011;

Donator/Partner: Bashkimi Europian, Caritas International - Belgjikë


V V ÑM QD ÇÇÇÇ EF M DME H ÇÇ M V Ç P V Ñ P Ñ D ÇÇ P M Ñ
projektin “Përforcimi i konkurrencës së agro-bizneseve dhe zhvillimi i turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës.” Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian dhe Caritas Internacional – Belgjikë, ndërsa rajoni implementues është zona jugore e Kosovës. Objektiva e këtij projekti është që të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës në mënyrë që të lehtësojë stabilizimin dhe integrimin e saj në kuadër të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Përveç kësaj, projekti synon ringjalljen e ekonomisë rurale të Kosovës për të zbutur varfërinë dhe për të zvogëluar eksodin rural dhe migracionin duke ofruar mundësi të reja të punës në zonat rurale. Po ashtu, kontribuohet në ndërtimin e aftësive profesionale dhe rrjeteve të bizneseve të vogla dhe të mesme (SMAE) në zonat rurale të Kosovës duke aplikuar një qasje nën-sektoriale. Projekti gjithashtu ka për qëllim gjenerimin e mundësive të vetë-punësimit në zonat rurale dhe mundëson mbijetesën e bizneseve familjare të bujqësisë në Kosovë.

Projekti fokusohet në gjashtë sektorët e agronomisë, siç janë: përpunimi i qumështit dhe djathit, përpunimi i mishit, prodhimi i perimeve, prodhimi dhe përpunimi i frutave, duke përfshirë edhe prodhimin e frutave të egra dhe këpurdhat.

Angazhimi ynë gjatë vitit 2011 është përqendruar kryesisht në sektorin e agronomisë. Deri në njëqind e dyzet përfitues,

individw dhe biznese të vogla dhe të mesme të të gjithë sektorëve të agronomisë, kanë marrë grante për makineri dhe pajisje, duke përfshirë si dhe mbulimin e kërkesave sipas nevojës. Grantet kanë mbuluar gjashtë komunat në rajonin jugor të Kosovës, siç janë: Prizreni, Suhareka, Dragashi, Rahoveci, Mamusha, dhe Malisheva.

Në vitin e dytë të projektit (2012), Caritas Kosova do të përqëndrohet më intenzivisht në zhvillimin e turizmit rural në rajonin jugor të Kosovës, pasi që dihet se rajoni jugor është i rrethuar me male të bukura, ku në vitin 1993 Malet e Sharrit janë konsideruar si Parku Kombëtar i Kosovës. Fakt është që rajoni i jugut ofron mundësi të larmishme për turizëm rural, por që ka ende nevojë të zhvillohet. Prandaj, Caritas Kosova do të jetë më aktiv në këtë perspektivë dhe në përputhje me qëllimin e projektit në mënyrë që të vazhdojë të mbështes popullsinw jugore në zhvillimin dhe promovimin e turizmit rural.



Shpenzimet e struktures - Buxheti i vitit 2011
CARITAS KOSOVA - FERIZAJ

Shpenzimet e struktures - Buxheti i vitit 2011					
CARITAS KOSOVA - FERIZAJ					
Periudha kohore		Njesia	Buxheti	Të hyrat & shpenzimet	Bilanci
Nr	Pershkrimi				
a		b	c	d	e=c-d
f=d/c					
A - Te hyrat					
	Burimet vendore dhe ato te jashtme		5730.00	1805.95	3924.05
1	Kontributi per shpenzimet e struktures (Caritasi Belg)		0.00	6700.00	0.00
	Mbulimi i shpenzimeve te struktures (ESF)		35000	15000	20000
2	Kontributi nga fondi I solidaritetit (CaCH)	1	0.00	10,000.00	-10,000.00
3	Kontributi nga fondi I solidaritet (Caritas France)	1	0.00	5,000.00	-5,000.00
4	Kontributi nga fondi I solidaritetit (Caritas Network)		35,000.00	0.00	35,000.00
	Kontributet nga menaxhimi i projekteve		36,695.77	44,102.62	
5	Shpenzimet e projektit ne zyren regjionale- Mitrovice	1	3,580.00	1,335.19	2,244.81
6	Shpenzimet e projektit "Grate se bashku per te drejtat e njeriut"	1	3,120.00	1,687.95	1,432.05
7	Shpenzimet e projektit "Programi- Socio-Pastoral "	1	1,560.00	1,500.00	60.00
8	Shpenzimet e projektit: "Programi i Asistences"- Gjilan	1	1,250.00	1,116.05	133.95
9	Shpenzimet e projektit:"Programi diocezan I animacioneve"	1	1,325.00	3,028.06	-1,703.06
10	Shpenzimet e projektit: Qendra Sociale-Edukative- Dubrave	1	4,000.00	4,080.00	-80.00
11	Shpenzimet e projektit -" Perkujdesi Shtepiak"	1	5,720.00	7,187.70	-1,467.70
12	Shpenzimet e projektit: Programi Nacional per personat me nevoja te vecanta "	1	3,340.77	3,931.86	-591.09
13	Shpenzimet e projektit: "Dita Nderkombetare e Vullnetareve"	1	520.00	0.00	520.00
14	Shpenzimet e projektit: "Asistence per te kthyerit "	1	4,800.00	2,014.21	2,785.79
15	Shpenzimet e projektit: " Programi I anti-trafikimit ne Kosove"	1	5,280.00	7,165.37	-1,885.37
16	Shpenzimet e projektit: Promovimi I Pages	1	1,580.00	1,435.41	144.59
17	Shpenzimet e projektit "RAE Prizren" (Caritasi I Zvicrres)	1	620.00	1,281.00	-661.00
18	Ambulanca (Dubrave)	1	0.00	533.05	0.00
19	Programi I Shendetesise (Suhareke)	1	0.00	5,188.00	0.00
20	Shpenzimet e projektit : " Projekti mbi reduktimin e rrezikshmerise nga fatkeqesite natyrore"	1	0.00	1,925.00	0.00
21	Konstruktimi I dyshemese (Stubell)	1	0.00	400.00	400.00
22	Projekti Ali Ibra (shpenzime administrative)	1	0.00	293.77	0.00
	Shpenzimet e udhetimit	1	1,800.00	10,590.01	0.00
24	Udhetimet, akomodimi, ushqimi (Takimet e rrjetit Caritas - forumet, punetorite, trajnimet,etj.)	1	1,800.00	4,042.01	-2,242.01
25	Shpenzimet e udhetimit ne vizitat studimore		0.00	5,888.00	5,888.00
26	Kontributet ne shpenzimet e udhetimit ne kuader te projektit		0.00	660.00	0.00
	Te paparashikuara		0.00	12,413.70	
27	Transfer parash (ECLO - pagesa takses)		0.00	5,863.70	-5,863.70
28	Transfer parash (DELTA - pagesa e qerase)		0.00	2,000.00	2,000.00
29	Rimbursim per riparimin e vetures		0.00	4,550.00	4,550.00
Totali :			79,225.77	90,612.28	19,115.26
B - Shpenzimet -					
1	Personeli	1	41,220.00	53,680.95	-12,460.95
1.1	Pagat	3	33,120.00	38,799.05	-5,679.05
1.2	Shpenzimet shtese (taksat, sigurimi social)	6	3,300.00	6,590.40	-3,290.40
1.3	Pgesa e taksave (Projekti BE -shiko te hyrat - 28)		0.00	7,661.50	7,661.50
1.4	Trajnime dhe ngritja e kapaciteteve	4	4,800.00	630.00	4,170.00
2	Komunikimi	12	2,100.00	1,836.30	263.70
2.1	Posta / telefoni / faksi	12	2,100.00	1,836.30	263.70
3	Objekti - hapësira e zyreve	12	8,000.00	1,610.81	6,389.19
3.1	Qeraja dhe mirembajtja e objektit	12	4,700.00	417.00	4,283.00
3.2	Pastrimi / sistemi I ngrohjes / rryma / uji	2	2,500.00	1,193.81	0.00
3.3	Taksat	2	800.00	0.00	800.00
4	Veturat	3	6,854.00	7,546.42	-692.42
4.1	Karburanti, mirembajtja, riparime	2	3,800.00	6,977.26	-3,177.26
4.2	Sigurimi dhe taksat	12	3,054.00	569.16	2,484.84
5	Shpenzime te ndryshme administrative	12	8,251.77	11,603.78	-3,352.01
5.1	Shpenzimet e udhetimit	12	2,040.00	11,187.78	-9,147.78
5.2	Materiale per zyre / mirembajtje / mirembajtja e pajisjeve	12	2,800.00	416.00	2,384.00
5.3	Furnizimi me pajisje te vogla dhe aparature	12	2,100.00	0.00	2,100.00
5.4	Dokumentacioni / publikimet	12	1,311.77	0.00	1,311.77
6	Kontributet - pagesat	12	800.00	100.00	700.00
6.1	Auditimi financiar & qeveritare	12	800.00	100.00	700.00
7	Shpenzimet e financimit	12	1,100.00	1,456.71	-356.71
7.1	Honoraret / interesat / riblerjet/te paparashikuara / sherbimet e bankes	12	1,100.00	1,456.71	-356.71
8	Investime te vogla & amortizim	1	6,700.00	1,800.00	4,900.00
8.1	Qeraja (Zyra regjionale- Prishtine)	1	0.00	1,800.00	-1,800.00
8.2	Shpenzimet - amortizim	12	6,700.00	0.00	6,700.00
Shpenzimet ne total :			75,025.77	79,634.97	-4,609.20
					106.14

Caritas Kosova / Projektet e implementuara gjate vitit 2011

Projektet:		Donatoret	Buxheti
1	Ambulanca - Qendra Sociale- Edukative- (Dubrave)	Komuna e Ferizajt	12,353.35
2	Qendra Sociale- Edukative - Dubrave (Projektet)	KFOS, SOROS, KEC	18,011.72
3	Qendra Sociale- Edukative -Dubrave	Komuna e Ferizajt	39,767.77
4	Programi i asistences sociale (Gjilan)	Caritas Kosova	2,700.00
5	Programi diocezan i animacioneve	Caritas France,Caritasi I Zvicrres,Caritasi i Luxemburgut	19,870.07
6	Perkujdesi Shtepiak	Caritasi Gjerman	87,002.97
7	Programi i anti-trafikimit	Caritas France; Caritasi I Zvicrres; CRS	31,538.17
8	Grate se bashku per te drejtat e njeriut	Komisioni Evropian	47,333.32
9	Asistence per te kthyerit vullnetare	Caritasi Belg	91,352.52
10	Programi Nacional per personat me nevoja te vecanta	Caritasi Gjerman	35,054.40
11	Forcimi i organizatave te fermereve- Regjioni i Ibrit	Caritasi Belg	118,243.66
12	Forcimi i rrjetit te organizatave te shoqerise civile -Gjilan	Caritasi Italian	21,513.28
13	Forcimi i Caritas-eve te famullive	Caritas Luxemburgu; C. Zvicrres, C.Italian; Komuna- Viti	29,000.00
14	Projekti ne Dubrave	Komuna e Ferizajt	15,446.54
15	Forcimi i konkureses se agro- bizneseve dhe zhvillimi i turizmit rural ne Kosoven Jugore	Komisioni Evropian	197,036.66
16	Promovimi i Pages	Caritasi I Zvicrres	15,812.60
17	Zyra Regjionale (Prizren)	Caritasi Gjerman; Caritasi I Zvicrres	76,121.44
18	Programi- Socio Pastoral	Caritasi Italian	9,148.66
19	Qendra e degjimit (Ferizaj)	Katholisches Pfarramt Obing; Komuna e Vitise	29,908.10
20	Qendra per rehabilitimin e droges (Vernakolle)	Caritas Kosova, Caritas Umbria	4,800.00
21	Integrimi i komuniteteve RAE (Gjakove)	Caritasi i Zvicrres	350.00
22	Perkujdesi shtepiak (Suhareke)	Komuna e Suharekes	42,883.18
23	Perkujdesi Shtepiak / Ambulanca (Ferizaj)	Komuna e Ferizajt	38,927.20
24	Qendra e degjimit (Mitrovice)	Caritasi Diocesian- Rome	8,507.07
26	Zyra regjionale (Mitrovice)	Caritas France;UNICEF;DRC; UNDP; Komuna	110,837.97
Total/EUR :			1,103,520.65

Caritas Kosova

*“Faleminderit për përkrahjen
dhe përkushtimin tuaj”*

Stafi i Caritas Kosovës



Falenderim i veçantë i shkon institucioneve dhe partnerëve të Caritaseve

Caritas Internationalis
 Caritas Europa
 Deutscher Caritas Ferband
 CRS
 Secours Catholique
 Caritas Italiana
 Caritas Schweiz
 Caritas Belgium
 Caritas Luxembourg
 Caritas Innsbruck
 Caritas Diocesana di Roma
 PTK
 Prishtina International Airport "Adem Jashari"
 Municipality Suharekë
 Municipality Ferizaj
 Municipality Mitrovicë
 European Union
 Swiss Cooperation Office Kosovo
 DRC
 KEC
 UNDP
 UNICEF
 SOROS
 Santa Maria Regina Terni
 Junge Leute Helfen

